



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 133/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z Goran Milenković.– Kryetar, Nuhi Paçarizi, - Referues, z.- Blerim Dina Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Rojet e Nderit”- Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “IK.S.A.S-Security sh.p.k” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objektit të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimi: 616-17-5437-211, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) /KK-Prishtinë/ më datën 07.05.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Rojet e Nderit”- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objektit të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimi: 616-17-5437-211 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK-Prishtinë"

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së /KK-Prishtinë/ lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objektit të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimi: 616-17-5437-211, dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Rojet e Nderit”-Prishtinë aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 25.12.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt: 05.02.2018

Letra standarde për Operatoret Ekonomik si tenderues të eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 22.03.2018

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritet Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 26.03.2018, ku është rekomanduar për kontratë OE- -“I.K.S.A.S-Security”sh.p.k

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Rojet e Nderit”-Prishtinë me dt: 28.03.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 30.03.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE “Rojet e Nderit”-Prishtinë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Rojet e Nderit”- Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.04.2018 me nr. 133 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objektit të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimi: 616-17-5437-211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK-Prishtinë" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,60,65,66,si dhe neni 30.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.04.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 19.04.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues "Rojet e Nderit"-Prishtinë se ka pasur shkelje të LPP gjegjësisht nenit 7, 59, 60, 65, 66, si dhe neni 30.1, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim: OE ankues "Rojet e Nderit" Sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila nuk i ka pretendimet e njëjta, sikur pretendimet e paraqitura në kërkesën për shqyrtim e parashtruar në AK-Komuna e Prishtinës, në kërkesën për shqyrtim nuk janë pretendimet, se janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 60, 65 dhe 66 i LPP-së, si dhe analiza financiare në kërkesë mungon.

OE ankues në ankesë pretendon se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim) por nuk ka dhënë fakte dhe argumente se ku janë bërë këto shkelje.

Eksperti shqyrtues profesional, gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të ofertave, konstaton se ky pretendim është i pa bazuar se nuk ka prova dhe argumente se nuk është respektuar neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim).

OE ankues me datën 27.03.2018, ka pasur qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, dhe pretendon se nuk është respektuar nenin i 59 LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve, përveç kopje të licencave të punëtorëve që kishte sjell. Nuk kishte sjell dëshmi të tjera, vërtetimi i ATK-së dhe i gjykatës ishin të njëjta dhe njeri nga anëtarët e konzorciumi vërtetimin e gjykatës e kishte jo valid (me afat të skaduar). Kërkesa e AK ka qenë që Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës duhet të dorëzohet Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej origjinali ose kopja.

Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali ose kopja vetëm.

Deklaratën e OE e nënshkruar dhe e vëlosur (fituesi i tenderit duhet të sjell kopjet e licencave) - para publikimit të njoftimit për dhënie të Kontratës.

Eksperti shqyrtues, konstaton, se për këtë aktivitet të prokurimit me 02.03.2018 është bërë njoftimi për dhënie të kontratës. Me datën 06.03.2018, OE "Rojet e Nderit" ka bërë kërkesë për shqyrtim të këtij aktiviteti, AK -Komuna e Prishtinës, ka aprovuar pjesërisht kërkesën, me datën 07.03.2018 dhe ka

kthyer aktivitetin e prokurimit në Rivlerësimi, për shkak se OE i rekomanduar ende nuk i ka plotësuar kërkesat sipas dosjes së tenderit- fituesi i tenderit Duhet te sjell kopjet e licencave para publikimit të njoftimit për dhënien e të kontratës.

Grupi i OE "K.S.AS-Security" Sh.p.k "Komtel Project Engineering" Sh.p.k, i Rekomanduar për kontratë është i njoftuar me datë 27.02.2018 përmes letrës standarde se është i rekomanduar për kontratë. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dëshmitë që janë kërkuar në bazë të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit:

Anëtari i Grupit "K.S.AS-Security" Sh.p.k nga Prishtina , ka prezantuar Vërtetimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër AGJ 778/2018 të datës 06.03.2018,Vërtetimin e ATK-së se nuk ka obligime tatimore me numër 1000439363 të datës 22.02.2018.

Anëtari i Grupit "Komtel Project Engineering" Sh.p.k nga Prishtina , ka prezantuar Vërtetimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër AGJ 4006/2017 të datës 20.09.2017,Vërtetimin e ATK-së se nuk ka obligime tatimore me numër 1000416733 të datës 08.12.2017. Në bazë të nenit 65 të LPP-së , përdhja kohore e përcaktuar në këtë nen ndërlidhet me përdhën që menjëherë i paraprin data e publikimit të njoftimit të kontratës. /Data e njoftimit te kontratës është 25.12.2017/.

Grupi i OE "K.S.AS-Security" Sh.p.k& "Komtel Project Engineering" Sh.p.k,ka vepruar ne bazë të njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit , me 21.03.2018 ka dorëzuar listën e licencave siç është kërkuar par publikimit të njoftimit për dhënie te kontratës .

Eksperti shqyrtues profesional konstaton se AK ,ka zbatuar në mënyrë te drejtë neni 59 të LPP-së lidhur me vlerësimin e tenderëve ,dhe është i pa qëndrueshëm pretendimi i ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm .

OE ankues , pretendon se AK nuk ka respektuar neni 30.1 ,Kriterin e dhënies së kontratës që është caktuar ne FDT(Fletën e dosjes së tenderit), "tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë" , është i pa qëndrueshëm sepse OE i rekomanduar për kontratë është vlerësuar i përgjegjshëm dhe ka çmimin më të ultë 439.401,60€ , ndërsa OE ankues është i përgjegjshëm dhe ka çmimin 487.500,00,€ , ankues është më i lartë 48.098.40€ se sa fituesi.

Eksperti Shqyrtues konstaton se AK ka respektuar neni 30.1 të FDT kriterin e dhënies së kontratës ,deri sa ka rekomanduar për kontratë tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ultë.

OE ankues pretendon se OE të cilët kanë çmimin më të lirë se 1.63 € për orë(paga mujore 176ore

$x1.63=286.88\text{€}$) nuk e plotësojnë as për së afërmi kërkesat AK-së lidhur me pagat.

Kërkesa e AK lidhur me mundësit teknike dhe profesionale është; OE duhet te deklarohet se punëtorëve do tua paguaj pagën minimale bruto 230€.

OE i Rekomanduar për kontratë ka dhen deklaratën me shkrim se punëtorive do të u paguaj pagën minimale bruto 230.00€. OE i rekomanduar për kontratë çmimin për orë pune e ka prezantuar 1.52€për orë(paga mujore 176 orë $x1.52=267.52\text{€}$), do të thotë se i plotëson kërkesat e AK dhe është i përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara ne njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit sipas nenit 69 të LPP-së, dhe si të tillë pretendimi i ankuesit është i pa qëndrueshëm.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Rojet e Nderit ”sh.p.k , të hedhet si e pa bazuar , për arsyen se AK-Komuna e Prishtinës ka zbatuar dispozitat e LPP-së „për aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-17-5437-211 , iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –“ Komuna e Prishtinës,dhe të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit sipas dispozitave të LPP-së.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.05.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoriteti kontraktues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE-së z.Hasani deklaroj: Ne kundërshtojmë fuqishëm vendimin e AK-KK Prishtinë për dhënie të kontratës OE të rekomanduar për kontratë. Oferta e

rekomanduar nuk plotëson elementin bazë çmimin për orë pune, të kërkuar nga AK-KK Prishtinë, ku paga bazë e kërkuar ka qenë 230 € bruto.

Në tabelën tonë kemi kalkuluar ofertën prej 230 €, kështu që nëse është paga bruto 230 €, 5% është i obliguar të paguaj punëdhënësi, që i bie të jetë 11.5 € të jetë kontributi punëdhënësit, që në total i bie 241.5€, ndërsa kur i shtojmë edhe TVSH që secili OE është i obliguar, i bie paga për një punëtor 284.97 € një punëtor sipas ligjit të punës ka drejtë të punoj 174 orë në muaj, dhe në përpjesëtim i bie çmimi për një orë pune 1.63€.

Ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar çmim prej 1.52 € që jo vetëm se nuk plotëson kriterin bazë, 5% për trust por edhe TVSH nuk e ka kalkuluar në çmim.

Kështu që ky çmim është plotësisht është nën çdo kriter të kërkuar nga AK. Gjithashtu do isha lidhur me një çështje, pasi çmimi është shumë i thjesht në këtë rast. Te vërtetimi i gjykatës, do cek se lidhur me pretendimin tonë se mungojnë vërtetimi i ATK dhe certifikata e gjykatës, AK e ka hedh poshtë këtë pikë duke thënë se kanë qenë në dosje.

Ne kemi kërkuar përmes Emilit të na dërgojnë dëshmitë, dhe në emalin e pranuar KK Prishtinë ka bashkangjitur vërtetimin e ATK dhe certifikatën e gjykatës për OE të rekomanduar për kontratë. Të dhënat e certifikatës së gjykatës kanë qenë se certifikata është nxjerr me datë 06.03.2018, ndërsa qasja jonë ka qenë me 05.03.2018.

Kështu që kjo certifikatë nuk ka ekzistuar në dosje të tenderit dhe është ofruar një ditë pas kërkesës tonë qasje në dokumente. Andaj kërkojmë nga OSHP që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj.Sekiraqa deklaroj: AK konstaton se vlerësimi është bërë konform të gjitha dispozitave ligjore, dhe pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertit që AK të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

Komisioni vlerësues ka konstatuar se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është në pajtim me kërkesat e AK-së, e të njëjtën gjë e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues.

Sa i përket vërtetimit të ATK dhe certifikatës, ankesa e OE është aprovuar pjesërisht dhe është kthyer lënda në rivlerësim me cilin rast është kërkuar nga OE sqarim, ku është plotësuar lënda me certifikatë dhe vërtetim nga Gjykata.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Hasani deklaroj: Do doja të shtoj se me kërkesën tonë ATK ka bërë një modul online ku ndër to është kalkulimi i pagës, dhe përmes kësaj mund të shihet se me çmimin e ofertuar të OE fitues nuk arrihet paga 230 € bruto. OE nuk plotëson as elementin bazë Trustin Pensional e lëre më edhe TVSH-në.

Eksperti nuk di a i ka ikur ky detal por çmimi online mund të analizohet dhe ky çmim është nën çdo kriter të AK-së.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraga deklaroj: Pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues që të vërtetohet vendimi i AK-së dhe propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj ankesën e OE ankues si të pabazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, sqarimeve dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues, parashtresave të palëve procedurale, deklaratave të palëve në seancë, vjen në përfundim se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të kërkojnë sqarime shtesë dhe të vërtetohet në veçanti se OE i rekomanduar për kontratë, a e plotëson kërkesën e AK-së në lidhje me pagën e punëtorëve prej 230 euro bruto në muaj, pra të bëhet një analizë detale e çmimeve dhe të analizohet në detaje se operatori i rekomanduar për kontratë, a i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK-Prishtinë"

1x1 OE - "Rojet e Nderit"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.